



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:064864

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05740220

KPPP.nr. 1321/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit NP IHK “Infrakos” Sh.A., me seli në Fushë Kosovë, rr. “Sheshi i Lirisë”, p.nr., kundër debitorit “Petrol Company” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70407467 dhe seli në Magjistralen Prishtinë – Fushë Kosovë, p.nr., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 173/23, i lejuar me datë 04.08.2023, nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 27.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit “Petrol Company” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70407467, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr. 173/23, i lejuar me datë 04.08.2023, nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, për pjesën e detyrimit në shumë prej EUR 9,693.48.
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit “Petrol Company” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70407467, ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 173/23, i lejuar me datë 04.08.2023, nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, për borxhin në lartësi prej EUR 48,216.98, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. Q-11-31997, e datë 31.08.2022; Faturës nr. Q-11-32286, e datës 30.09.2022; Faturës nr. Q-11-32367, e datës 30.09.2022; Faturës nr. Q-11-32368, e datës 30.09.2022; Faturës nr. Q-11-32392, e datës 30.09.2022; Faturës nr. Q-11-32393, e datës

30.09.2022; Faturës nr. Q-11-32576, e datës 31.10.2022; Faturës nr. Q-11-32655, e datës 31.10.2022; Faturës nr. Q-11-32656, e datës 31.10.2022; Faturës nr. Q-11-32669, e datës 31.10.2022; Faturës nr. Q-11-32670, e datës 31.10.2022; Faturës nr. Q-11-32865, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-32875, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-32876, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-32877, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-33395, e datës 31.01.2023; Faturës nr. Q-11-33427, e datës 31.01.2023; Faturës nr. Q-11-33432, e datës 31.01.2023; Faturës nr. Q-11-33433, e datës 31.01.2023; Faturës nr. Q-11-33434, e datës 31.01.2023; Faturës nr. Q-11-33547, e datës 28.02.2023; Faturës nr. Q-11-33579, e datës 28.02.2023; Faturës nr. Q-11-33584, e datës 28.02.2023; Faturës nr. Q-11-33585, e datës 28.02.2023; Faturës nr. Q-11-33586, e datës 28.02.2023; Faturës nr. Q-11-33873, e datës 31.03.2023; Faturës nr. Q-11-33874, e datës 31.03.2023; Faturës nr. Q-11-33875, e datës 31.03.2023; Faturës nr. Q-11-33896, e datës 31.03.2023; Faturës nr. Q-11-34020, e datës 31.03.2023; Faturës nr. Q-11-32878, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-32879, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-32954, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-32955, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-32980, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-32981, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-33013, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-33014, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-33015, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-33016, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-33017, e datës 30.11.2022; Faturës nr. Q-11-33110, e datës 31.12.2022; Faturës nr. Q-11-33179, e datës 31.12.2022; Faturës nr. Q-11-33180, e datës 31.12.2022; Faturës nr. Q-11-33194, e datës 31.12.2022; Faturës nr. Q-11-33195, e datës 31.12.2022; Faturës nr. Q-11-33196, e datës 31.12.2022; Faturës nr. Q-11-33103, e datës 31.12.2022; Faturës nr. Q-11-34049, e datës 31.03.2023; Faturës nr. Q-11-34247, e datës 30.04.2023; Faturës nr. Q-11-34258, e datës 30.04.2023; Faturës nr. Q-11-34324, e datës 30.04.2023; Faturës nr. Q-11-34341, e datës 30.04.2023; Faturës nr. Q-11-34529, e datës 31.05.2023; Faturës nr. Q-11-34541, e datës 31.05.2023; Faturës nr. Q-11-34621, e datës 31.05.2023; Faturës nr. Q-11-34636, e datës 31.05.2023; Faturës nr. Q-11-34833, e datës 30.06.2023; Faturës nr. Q-11-34845, e datës 30.06.2023; Faturës nr. Q-11-34925, e datës 30.06.2023; Faturës nr. Q-11-34940, e datës 30.06.2023; Faturës nr. Q-11-34971, e datës 31.07.2023; Faturës nr. Q-11-35053, e datës 31.07.2023; Faturës nr. Q-11-35136, e datës 31.07.2023, dhe Faturës nr. Q-11-35153, e datës 31.07.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 173/23, të datës 04.08.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që sipas faturave të lartcekura, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 57,910.46, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është marrë urdhri përmbartues nuk ka titull ekzekutiv ose tipare të përmbartueshmërisë, ashtu që propozimi për përmbartim është lejuar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbartimore. Më tej, ka theksuar se propozimi për përmbartim nuk përmban origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm. Ka shtuar se pretendimet se nuk kanë përmbushur obligimet ndaj kreditorit janë në kundërshtim me transaksionet monetare e që dëshmohet edhe përmes pagesave bankare, të cilat vërehen nga pasqyrat bankare jo vetëm të debitorit, por edhe të kreditorit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbartimor kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm. Ka shtuar se me datë 14.02.2023 kanë arritur marrëveshje – proces barazimi me debitorin, sipas së cilës është konstatuar që borxhi i debitorit është në shumë prej EUR 73,314.09 deri me datë 31.12.2022, ashtu që janë dakorduar që kjo pagesë të përmbushej në 11 këste, duke filluar nga muaji shkurt 2023 me këstin e parë në shumë prej EUR 6,664.92, deri në muajin dhjetor 2023 me këstin e fundit prej EUR 6,664.92. Tutje, ka theksuar se përpos detyrimit të rregullt, debitori ka dështuar t'i përmbahet edhe marrëveshjes. Andaj, gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta lej në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbartimor P.nr. 173/23, i lejuar me datë 04.08.2023, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori në lartësi prej EUR 9,693.48, sipas faturave nr. Q-11-33014, nr. Q-11-33015, nr. Q-11-33016, nr. Q-11-33875, nr. Q-11-33874, nr. Q-11-33873, nr. Q-11-34020, nr. Q-11-34049, nr. Q-11-35053, nr. Q-11-35136, si dhe nr. Q-11-35153, pasi që faturat në fjalë nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme, për faktin që nuk janë pranuar nga debitori, konkretisht nuk janë të nënshkruara apo të vulosura nga i njëjti. Ndërsa, kreditori nuk ka ofruar asnjë dëshmi se faturat në fjalë i janë dorëzuar debitorit në ndonjë formë tjetër të përshtatshme dhe se debitori ka qenë në dijeni për detyrimin që buron nga të njetat fatura. Prandaj, gjykata gjen se prapësimi i debitorit për këtë pjesë të detyrimit është i bazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke anuluar pjesën e urdhrin përmbartimor në lartësi prej EUR 9,693.48.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, duke e refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr. 173/23, i lejuar me datë 04.08.2023, për shumën në vlerë prej EUR 48,216.98, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se për pjesën e lënë në fuqi urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht në faturat nr. Q-11-31997, nr. Q-11-32286, nr. Q-11-32367, nr. Q-11-32368, nr. Q-11-32392, nr. Q-11-32393, nr. Q-11-32576, nr. Q-11-32655, nr. Q-11-32656, nr. Q-11-32669, nr. Q-11-32670, nr. Q-11-32865, nr. Q-11-32875, nr. Q-11-32876, nr. Q-11-32877, nr. Q-11-33395, nr. Q-11-33427, nr. Q-11-33432, nr. Q-11-33433, nr. Q-11-33434 nr. Q-11-33547, nr. Q-11-33579, nr. Q-11-33584, nr. Q-11-33585, nr. Q-11-33586, nr. Q-11-33896, nr. Q-11-32878, nr. Q-11-32879, nr. Q-11-32954, nr. Q-11-32955, nr. Q-11-32980, nr. Q-11-32981, nr. Q-11-33013, nr. Q-11-33017, nr. Q-11-33110, nr. Q-11-33179, nr. Q-11-33180, nr. Q-11-33194, nr. Q-11-33195, nr. Q-11-33196, nr. Q-11-33103, nr. Q-11-34247, nr. Q-11-34258, nr. Q-11-34324, nr. Q-11-34341, nr. Q-11-34529, nr. Q-11-34541, nr. Q-11-34621, nr. Q-11-34636, nr. Q-11-34833, nr. Q-11-34845, nr. Q-11-34925, nr. Q-11-34940, dhe nr. Q-11-34971, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre është treguar kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është

përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Tutje, gjykata gjen se faturat janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa të njejtat janë pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori dhe se të njejtat fatura burojnë nga kontrata e qiradhënies e lidhur mes këtu palëve ndërgjyqëse. Rrjedhimisht, gjykata gjen se debitori ka qenë i njoftuar me përmbajtjen dhe detyrimet që burojnë nga këto fatura, ndërsa të njejtat nuk i ka kundërshtuar më parë.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njejtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata mori parasysh pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim lidhur me pagesat e realizuara, mirëpo gjeti se për pjesën si në pikën II të dispozitivit, debitori nuk ka paraqitur prova të cilat do të vërtetonin përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit ashtu siç kërkohet me nenin 69.4 të LPP-së, sipas së cilit *“Për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.”*

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera mirëpo gjeti se të njejtat nuk paraqesin bazë për anulimin e tërësishëm të urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1321/23, datë 27.05.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.